

Anketa e Buxhetit të Familjes

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	4
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	5
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia.....	6
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave	9
18. Përpunimi statistikor.....	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Anisa Omuri
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës Sektori
1.5. Adresa postare	Blv. “Zhan d’Ark”, Nr.3 Tiranë, Shqipëri
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	aomuri@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+355(4)22233357
1.8. Numri i faksit	+355(4)2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	01.10.2018
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	30.10.2017
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	01.10.2018
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri.</p> <p>Objektivi kryesor i mbledhjes së të dhënave është përlllogaritja e nivelit dhe strukturës së të ardhurave, shpenzimeve të konsumit në nivel vendi dhe sipas qarqeve. Avantazhi që ka ABF mbi burimet e tjera të informacionit për konsumin është se vrojtimi merr informacion në nivel familje, anketa gjithashtu merr informacion rreth karakteristikave të familjes dhe pjesëtarëve të saj.</p> <p>Të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes përdoren për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve si një agregat i rëndësishëm i Llogarive Kombëtare. Mbajtja i një ditari të detajuar të shpenzimeve të familjeve gjate periudhës dy-javore nga familjet e përzgjedhura është veçoria kryesore e ABF-së.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>ABF mbledh informacion mbi shpenzimet e konsumit sipas klasifikimeve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP-6 shifror 2012) http://www.instat.gov.al/media/339465/abf_2015.pdf 2. Klasifikimi European i Aktiviteteve Ekonomike (NACE rev2)

	<p>http://www.instat.gov.al/media/252541/nve.pdf</p> <p>3. Sistemi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Standardeve të Arsimit (ISCED 97) http://www.unesco.org/education/information/nfsunesco/doc/isced_1997.htm</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Grupet kryesore të konsumit janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), 2012 si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 01. Ushqime dhe Pije jo-Alkoolike 02. Pije Alkoolike dhe Duhan 03. Veshje dhe Këpucë 04. Strehimi, Uji, Energjia Elektrike dhe Lënde të tjera Djegëse 05. Mobilje, Pajisje për Shtëpinë dhe Mirëmbajtja e Zakonshme e Shtëpisë 06. Shëndeti 07. Transporti 08. Komunikimi 09. Argëtimi dhe Kultura 10. Arsimi 11. Restorante dhe Hotele 12. Të Mira dhe Shërbime të Ndryshme
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Shpenzimet për konsum të NjEF përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.</p> <p>Periudha e referencës është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.</p> <p>Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.</p> <p>Kryefamijari është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF). Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.</p> <p>Fëmijë është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është njësia ekonomike familjare.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore janë të gjitha NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Kampioni i vrojtimit mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.7. Zona e referencës	ABF mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë. Banesat kolektive, shtëpitë për të moshuarit, spitalet, shtëpitë e rehabilitimit, duke përfshirë spitalet për fëmijë, shkollat me konvikte, hotelet, sanaturimet, institucione korrektuese dhe penale nuk janë të përfshira në vrojtimit.
3.8. Mbulimi në kohë	ABF ka një shtrirje kohore një vjeçare në terren.

3.9. Periudha bazë	Nuk është e aplikueshme për ABF.
4. Njësia matëse	Shpenzimet për konsum të NjEF janë të matura në Lekë të reja.
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës është viti i plotë, Janar - Dhjetor 2017.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, Statistikat e ABF janë bazuar në: <ul style="list-style-type: none"> LIGJ Nr. 17/2018 “PËR STATISTIKAT ZYRTARE”. http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf Programin Kombëtar i Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021, http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/programi-kombetar-i-statistikave-zyrtare.aspx
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nuk është e aplikueshme për ABF.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga NjEF konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për nxjerrjen e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna botohen vetëm bashkërisht dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Rezultatet Finale publikohen 10 muaj pas fundit të vitit referencë (T+273 ditë). Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendarin e Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it. http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendar/

8.3. Aksesi i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikant zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e vërtetimit ABF janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Website – online release 2- Kërkesat e shkruara 3- Publikimet (publikimi vjetor i rezultateve të ABF-së, Vjetari Statistikor Rajonal, Vjetari Statistikor) 4- Pjesa e Info-s e dedikuar për të kontaktuar INSTAT <p>http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontaktoni/</p>
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Rezultatet e ABF publikohen në baza vjetore.
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë si shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF, shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve etj.</p> <p>Njoftimi për shtyp i ABF publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	<p>Rezultatet e ABF gjenden të botuara në Vjetarin Statistikor dhe atë Rajonal . Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsumi i Familjeve: <p>http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/</p>
10.3. Baza e të dhënave on-line	<p>Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e ABF nga viti 2006/2007. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik.</p> <p>Bazën e të dhënave mbi shpenzimet e konsumit të familjeve e aksesoni në linkun më poshtë:</p> <p>http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=ebd73686-919e-4389-a129-2b6a0ca6c3e5</p>
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat e ABF nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit.
10.5. Të tjera	<p>Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë:</p> <p>http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontaktoni/</p>

10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi vrojtimin në linkun e mëposhtëm:</p> <p>http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	<p>Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ABF për qëllime të brendshme.</p>
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikën Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p> <p>Procesi i hedhjes së të dhënave, është i programuar që minimizojë gabimet që vijnë nga procesi i mbledhjes së të dhënave. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave merr masa për të reduktuar mos-përgjigjet.</p> <p>Të dhënat e mbledhura krahasohen në lidhje me koherencën e brendshme, burimet administrative apo anketat e tjera pranë familjeve që INSTAT realizon duke garantuar një produkt final cilësor.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhënat e ABF krahasohen me të dhënat e ABF në vitet e kaluara për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e ABF-së ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët</p>

	<p>përdorin rezultatet e ABF si input në punën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Drejtoria e Statistikave Ekonomike
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Anketën e Buxhetit të Familjes për vitin 2017 janë rreth 3,199 klikime. Ndërkohë që në vitin 2016 ishin rreth 6,092 klikime. INSTAT gjatë vitit 2017 ka realizuar për herë të parë Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të statistikave për fushën e Konsumit të Familjes?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3, 20 .</p> <p>Më poshtë gjeni linkun e rezultateve të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. http://www.instat.gov.al/media/2974/anketa-mbi-kenaqesine-e-perdoruesve.pdf</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave, për Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF) 2017, është 83.3%. Kjo përlllogaritja ka marr në konsideratë tabelat e prodhuara nga EUROSTAT në raport me tabelat e prodhuara nga Sektori i Konsumit të Familjes për këtë anketë</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Çdo anketë e zhvilluar nga INSTAT bazohet në zgjedhjen e një kampioni për të nxjerrë përfundime për popullsinë në studim. Natyrshëm, ky proces shoqërohet me devijime statistikore. Për këtë arsye u llogaritën devijimet standarde të zgjedhjes të cilat përdoren për interpretimin e rezultateve të anketës.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Anketa e Buxhetit të Familjes 2017 u krye nga INSTAT përgjatë gjithë vitit, me një kampion prej 9312 NjEF. Në përfundim të vrojtimit ishin intervistuar rreth 7519 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë.</p> <p>Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 80.7 për qind.</p> <p>Për Anketën e Buxhetit të Familjes 2017, janë llogaritur devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes. Në tabelat A1 dhe A2 ne Anxin 1 jepen devijimet standarde dhe koeficientet e variacionit të shpenzimeve mesatare mujore për konsum sipas 12 grupeve kryesore të konsumit si dhe shpenzimet mesatare për konsum mujor sipas qarqeve.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p><u>Mos-përgjigja në nivel rekordi</u> merr në konsideratë familjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur familjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e Mos-përgjigjes nivel rekordi e papeshuar është 19.3%.</p> <p><u>Shkalla e Mos-përgjigjes në nivel variabli</u> për disa nga variablat e ABF janë: Qiraja e paguar (renta) është 3.339%, Renta e imputuar pa pajisje është 3.498%</p>

	<p>ndërsa Renta e imputuar me pajisje është 3.578 %</p> <p>Shkalla e mbi-mbulimit, tregon së sa përqind e e familjeve nuk duhet të ishin pjesë e anketës, pasi janë jashtë fokusit të anketës. Shkalla e mbi-mbulimit për ABF 2017 është 3.2%.</p>
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	Ky raport cilësie i referohet rezultateve të vitit 2017.
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat finale të ABF , publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve, i cili publikohet në faqen e internetit të INSTAT çdo vit.</p> <p>http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendari/</p> <p>Publikimi i ABF, ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të publikime të kryera gjatë viteve.</p>
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi treguesit e ABF janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi dhe qarku.
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Anketa e Buxhetit të Familjes është realizuar nga INSTAT në këto vite:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2006-2007 • 2008-2009 • 2014 • 2015 • 2016 • 2017 <p>Metodologjia ndër vite është përgjithësisht e njëjtë duke mundësuar kështu krahasimin kohor.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Kontrolle të rregullta të ndërthurura realizohen me informacione nga burime të tjera të INSTAT pasi rezultatet e këtij vrojtimi përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.

<p>16. Kostoja dhe ngarkesa</p>	<p>Personat që punojnë për ABF janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 4 punonjës • Stafi në Zyrat Rajonale, 28 punonjës • Intervistuesit, Operator, Kontrollor(Staf i përkohshëm i INSTAT): 94 Intervistues +6 Kontrollorë + 10 Operatorë
<p>17. Rishikimi i të dhënave</p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit të ABF bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <p>http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf</p> <p>http://www.instat.gov.al/media/2828/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf</p>
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Në fund të muajit maj 2014, INSTAT publikoi shifrat e plota të popullsisë për vitet 2001-2014 të cilat reflektonin ndryshimet e popullsisë që vinin nga Censusi i Popullisë dhe Banesave 2011. Këto shifra, si numri i popullsisë, numri i Njësiteve Ekonomike Familjare, popullsia sipas grup-moshave etj. sjellin ndryshime në përlllogaritjet e treguesve të tjerë me bazë popullsinë.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vrojtimi i ABF.</p>
<p>18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Të dhënat mblidhen në bazë vjetore.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plotësimi i një ditari të blerjeve (si dhe një ditari të vet-konsumit sa herë që familja deklaron se konsumon artikuj apo shërbime që i prodhon vetë) nga ana e NjEF për 14 ditë të njëpasnjëshme. • Kryerja e një interviste direkte nëpërmjet anketuesit në javën e parë të muajit pasardhës me periudhë reference muajin në të cilin është plotësuar ditari i blerjeve.
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e editimit të të dhënave në përgjithësi i referohen editimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel NjEF.</p> <p>1. Kontrolli fizik i pyetësit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i pyetësorëve të mbledhur, kontrole të tërësisë së plotësimit, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësit. Stafi kontrollues ka një program specifik për të kryer kontrollin fizik të pyetësorëve. Numri i pyetësorëve të mbledhur duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe. • Kontrole individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte.

	2. Korrigjimet aritmetike, korrigjimet logjike dhe verifikim i koherencës midis pjesëve të ndryshme të pyetësorit. Pas procesit të regjistrimit të të dhënave realizohet procesi i pastrimit dhe imputimit të të dhënave duke përdorur programet kompjuterike SCIA dhe RIDA.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Për përpilimin e rezultateve kemi dy procedura bazë:</p> <p>1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli matematik i anketës - Kontrolli logjik i të dhënave të anketës - Krahasimi i të dhënave në seri kohore -Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT <p>2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pa kontakt • Refuzim i plotë • Refuzime të pjesshme (për variabla apo tregues të veçantë). <p>Për trajtimin e mos-përgjigjeve të pjesshme u përdorën disa metoda të drejtpërdrejta ose kombinimi i tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studimi i serisë kohore; • Imputime sipas metodës me ngjashëri në nivel variablash demografik duke përdorur programet kompjuterike SCIA dhe RIDA ;
18.6. Rregullimi	Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga ABF.
19. Komente	

Aneks 1 Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për 12 grupet kryesore

Tabela A1. Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për 12 grupet kryesore të shpenzimeve për konsum

	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi Standart	Intervali i besimit 95%		Koeficienti i variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Shpenzimet mesatare gjithsej	73,400	603	72,218	74,581	0.8
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	32,347	199	31,958	32,736	0.6
Pije alkoolike dhe duhan	2,558	43	2,473	2,643	1.7
Veshje dhe këpucë	3,128	52	3,026	3,230	1.7
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	7,998	83	7,836	8,161	1.0
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	3,505	43	3,419	3,590	1.2
Shëndet	2,879	112	2,660	3,098	3.9
Transport	5,294	136	5,027	5,562	2.6
Komunikim	2,479	24	2,433	2,525	1.0

Argëtim dhe kulturë	2,224	68	2,091	2,357	3.1
Arsim	2,868	267	2,345	3,392	9.3
Restorante dhe hotele	3,638	135	3,374	3,902	3.7
Të tjera mallra dhe shërbime	4,480	70	4,344	4,617	1.6

Tabela A2. Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për shpenzimet për konsum sipas qarqeve.

Qarku	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi Standart	Intervali I besimit 95%		Koefficienti i variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Shpenzimet mesatare gjithsej	73,400	603	72,218	74,581	0.8
BERAT	69,948	2,024	65,980	73,916	2.9
DIBËR	47,467	1,330	44,860	50,075	2.8
DURRËS	76,129	1,927	72,352	79,906	2.5
ELBASAN	57,831	1,144	55,588	60,075	2.0
FIER	71,052	1,719	67,681	74,423	2.4
GJIROKASTËR	62,237	1,943	58,427	66,046	3.1
KORÇË	71,063	1,623	67,882	74,243	2.3
KUKËS	66,218	2,967	60,402	72,034	4.5
LEZHË	73,057	3,346	66,499	79,615	4.6
SHKODËR	73,306	1,907	69,568	77,044	2.6
TIRANË	87,968	1,401	85,221	90,715	1.6
VLORË	58,374	2,211	54,039	62,709	3.8